



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Bekim Lushaku	12.12.2025	18.12.2025	2025/1218

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 10.12.2025, OE “Euro Commerc”- Viti, ka parashtruar ankesë me nr: 2025/1218, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Rregullimi i parqeve dhe hapësirave publike ne zonën urbane te qytetit Lot 1 deri ne Lot 4” me nr. të prokurimit: "651-25-9957-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL- GJILAN.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës: pune, vlera e parashikuar e kontratës: 1,137,579.37€.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

--

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenet 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **651-25-9957-5-1-1**

Sa i përket tenderit për " Rregullimi I parqeve dhe hapsirave publike në zonën urbane të qytetit Lot 1 deri në Lot 4

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Euro Commere O.P.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga e Tiranës, p.n. Viti
(Adresa)

Viti
(Vendi)

044 322 753
(Numri Telefonit)

61000
(Kodi postar)

(Numri i Faks-it)

Enis Alidemi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
euro.comerc2023@hotmail.com
(Adresa elektronike)

10.12.2025
(Data e parashtrimit të ankesës)


(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Nga ana e AK-së, **KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**, me rastin e publikimit të procedurës së prokurimit të lartëcekure në përpilimin e dosjës së tenderit është vepruar në mënyrë të kundërligjshme duke i shkelur dhe zbatuar gabimisht dispozitat ligjore të LPP-së Nr. 04/L-042 (versioni i konsoliduar) dhe legjislacionit sekondar Rregullores Nr.002/2024 për Plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik si në vazhdim:

- | | | |
|------------|--------------------------------------|---------------------------|
| 1. Neni 1 | Qellimi i ligjit; | |
| 2. Neni 7 | Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi | Pika:1,2,3,4 dhe 6 të LPP |
| 3. Neni 27 | Dosja e tenderit | |
| 4. Neni 51 | Njoftimi i Kriterëve të Përzgjedhjes | |
| 5. Neni 69 | Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale | |
| | | |
| 1. Neni 25 | Pika 25.5, 25.4, 25.6 | të RRPP |
| 2. Neni 17 | Pika 17.17, 17.23 | |
| 3. Neni 61 | Pika 61.3 | |
| 4. Neni 62 | Pika 62.2 | |

Njëkohësisht AK me rastin e refuzimit të kërkesës për rishqyrtim ka bërë shkelje edhe të Nenit 108/A të LPP-së.

3/4

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe profesional: Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme(se paku 2 projekte të përfunduar të kësaj lëmie), për Lote jo më pak se Lot 1 – 600,532.00€ Lot 2 -590.845.00€ Lot 3-413,435.00€ Lot 4-101,560.00€ gjatë periudhës së shkuar 3 (Tre) vjeçare duke filluar nga data e Njoftimit për Kontratë.	Dëshmia e kërkuar dokumentare Dëshmia 1, Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 7, ku duhet saktësuar: titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit, si dhe listës t'i bashkëngjiten referencat ose certifikatat për punët e kryera (të përfunduara). Shenim Autoriteti Kontraktues ka të drejtën e verifikimit për secilin projekt
		Kërkesa 2. OE duhet të jetë i certifikuar me ISO standarde si në vijim: ISO: 14001-2015 ISO:45001-2018 ISO: 9001-2015	Dëshmia 2. Kopjet e certifikatave me validitet
		Kërkesa 3. OE duhet të ketë një auditor sipas kërkesave të standardit: EN ISO 9001 2015, EN ISO 1400 2015 dhe ISO 45001 2018	Dëshmia 3. Kontrata e punës, ose angazhim për këtë projekt si dhe Certifikata.

		Kërkesa 4. OE duhet te ofroj dëshmi për stafin profesional dhe atë si vijon: a). Menaxheri i projektit të jetë inxh. i diplomuar i ndertimtarisë- drejtimi konstruktiv (ose master) me minimum, 5 vite pervoje. Te jete i certifikuar per siguri dhe shendet ne pune, Te jete I certifikuar per menaxhim te kantierit te ndertimit. b) Udheheqesi i punishtes, Ing i ndertimtaris (Konstruktiv), i qertifikuar si specialist i siguris dhe kontrollit te cilësisë ne kantier, i qertifikuar për mbrojtje nga zjarri, i qertifikuar per hidroizolime ne ndërtesa, i qertifikuar për dhënie të ndihmes së parë dhe i qertifikuar për punë në lartesi. c) Një (1) bachelor të gjeodezisë osse master të licensuar nga AKK, ose Master me minimum, 3 vite pervoje. d). Një inxhinier te diplomuar ose master drejtimi Hidroteknik kërkohet të kete min 5 vite pervoje pune angazhime profesionale pas diplomimit dhe te kete menaxhur se paku nie projekt te ngjashem te ndertimit te objekteve publike. I Certifikuar per mbrojtje nga zjarri. I Certifikuar me ISO 9001 - 2015. I certifikuar me ISO 500001 2018 si dhe te jete Ekspert per klasesimin ndikimit ne mjedis. ~ ~	Dëshmia 4. Sa i përket pikës a dhe b, Për menaxherin e projektit dhe udheheqesin e punishtes, të paraqitet vendimi për përcaktimin e menaxherit të projektit dhe udheheqesit te punishtes, diplomat përkatëse , Certifikatat kopje Cv dhe referenca per pune te ngjashme per menaxherin e projektit dhe udheheqesin e punishtes. Kontrata e e rregullt e punës, në rast se angazhimi është vetëm për këtë projekt, kontratë për këtë projekt e nënshkruar nga të dy palët. Nëse diploma është e lëshuar nga ndonjë shtet tjetër, e njëjta duhet të jetë e nostrifikuar nga MASHTI. Deshmia c deri h. Kontrata e rregullt e punës, në rast se angazhimi është vetëm për këtë projekt, kontratë për këtë projekt e nënshkruar nga të dy palët; diplomat , CV dhe referencat, per kerkesen d dhe g, te bashkangjiten edhe certifikatat qe i posedojn inxh.
--	--	---	---

		e). Një (1) inxhinier të diplomuar ose master Drejtimi Arkitekture,kërkohej të ketë min. 3 vite përvojë pune në angazhime profesionale pas diplomimit i certifikuar për mbrojtje nga zjarri. f). Një inxhinier I Elektros, kërkohej të ketë se paku 5 vite përvoj pune, I Certifikuar per mbrojtje nga zjarri. g). Një (1) inxhinier të diplomuar ose bachelor i Ndërtimtarisë drejtimi Inxhinieri e Ambientit, kërkohej te ketë min. 5 vite përvojë pune – angazhime profesionale pas diplomimit si dhe të jetë Ekspert për vlerësimin e ndikimit në mjedis,i certifikuar me iso 14001-2015, e certifikuar per menaxhimin e projekteve. h). (Nje) Teknik te ndertimtarise i kualifikuar me shkolle te mesme profesionale 5 (pese) vite pervoje pune pas diplomimit. Kërkesa 5. Lista e stafit te OE,personeli i kualifikuar, se paku (25) punëtor ne mesataren e te punësuarve ne tri vitet e fundit, ku disa prej tyre të jenë personel i kualifikuar me pesë vite përvojë pune pas diplomimit një Ndërtimtar, një Arkitekt,një Makinerist, një Elektracistë,nje Hidro Instalues.	
--	--	--	--

		Kërkesa 6. Punëtor të trajnuar nje Armirues, nje Saldues. 6a) OE duhet te kete nje puntore te certifikuar si latues si dhe te jete I certifikuar per siguri dhe shendet ne pune si dhe per mbrojtje ndaj zjarrit dhe i certifikuar per rrezikun ne lartesi. 6.b) OE duhet te kete 1 saldues EN ISO 9606-1 me minimum 2 vite përvoj pune. 6.c) Nje Saldator sipas en iso 9712:2012 6.d) OE duhet të ketë te angazhuar njw person përgjegjës per sigurinë dhe mbrojtje ne e shëndetit ne pune 6.e) Tre punëtorë të trajnuar për përdorimin dhe manovirimin e mjeteve te punës.	Dëshmia 5. Listën e punëtorëve të operatorit ekonomik, e njëjta duhet të dorëzohet origjinal. Kontratat ose para kontratat mbi marrëdhënien e punës të minimum 10 punëtorëve, të cilet duhet te jene te trajnuar në siguri dhe shëndet në punë, listën e projekteve të evidentuar dhe nënshkruar. Për personelin e kualifikuar duhet të prezantohen diplomat kopje të shkollave profesionale të akredituara nga institucionet shtetërore Dëshmia: 6a, 6b, 6d, 6e, 6f duhet të prezantohen certifikatat e trajnimit nga i institucione apo trupa certifikues të akredituara nga republika e Kosoves. Kontratat kopje, ne rast angazhimi e per kete projekt duhet te kete kontraten per angazhim, e nenshkruar nga te dy palet si dhe certifikatat. 6.c) Kopje e Certifikates e verifikueshme online, kontratat e punes ose parakontrata original, ne rast
--	--	--	--

		6.0)Një Person të certifikuar për sistemet e drenazhimit. I certifikuar për siguri dhe shëndet në punë. I certifikuar për mbrojtje nga zjarri. Kerkesa 7. Vlerësimi i riskut nga një kompani e licencuar nga MPMS.	angazhimi kontrata per kete projekt. Deshmia 7. Operatori Ekonomik duhet të dëshmoj përmes një raporti, vlerësimin e riskut nga një kompani e licencuar nga MPMS.
		Kërkesa 8. OE duhet te paraqes nje liste te pajisjeve qe nevojiten per projektin ne fjale qe e gjeni ne Aneksin 7	Deshmia 8. Pajisjet rrugore të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet te jene me afat te regjistrimit), ndërsa pajisje tjera, OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD, kontrat etj). Vëmendje! Në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet të ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet të jetë në emer të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj Kontrate e nenshkruar dhe vulosur nga te dyja palët.

Numri i Prokurimit: **651-25-121-521** – Titulli **Rregullimi I parqeve dhe hapsirave publike në zonën urbane të qytetit Lot 1 deri në Lot 4 “**

Autoriteti kontraktues mund të bëjë verifikimin e çdo dokumenti si dhe inspektimin e kapaciteteve teknike, profesionale të gjithë operatorëve ekonomikë tenderues për qëllime të verifikimit.

Nëse operatori ekonomik ka paraqitur të dhëna të rrejshme automatikisht do të eliminohet nga vlerësimi dhe oferta e tij do të konsiderohet si ofertë e papërgjegjshme.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

N/A

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

OE është palë me interes.

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - Euro Commere

Përmbledhje e Shkeljeve Ligjore dhe Vlerësimi i Ekspertit

Nr.	Pretendimi i Shkeljes Ligjore	Vlerësimi i Ekspertit
1	Shkelje e Nenit 1 LPP (Qëllimi i Ligjit) – Fondet publike nuk janë shfrytëzuar në mënyrë efikase dhe transparente për shkak të vendosjes së kriterëve jo proporcionale dhe të panevojshme.	Eksperti vlerëson se kriteret teknike të panevojshme kanë penguar konkurrencën dhe mund të shkaktojnë keqshfrytëzim të fondeve publike. Kërkesat duhet të jenë të lidhura drejtpërdrejt me nevojat reale të projektit.
2	Shkelje e Nenit 7 LPP (Barazia dhe Mos-Diskriminimi), pika 1,2,3,4,6 – Operoret ekonomik nuk janë trajtuar në mënyrë të barabartë; kriterë të tepërta favorizojnë disa OE specifik.	Eksperti konstaton se vendosja e kriterëve të ngushta teknike pengon pjesëmarrjen e operatoreve të tjerë dhe krijon avantazh të padrejtë. Kërkesat duhet të jenë proporcionale dhe të arsyetuara.
3	Shkelje e Nenit 24 LPP – Detyrimi i AK-së për të siguruar që aktivitetet e prokurimit të kryhen në përputhje me ligjin nuk është respektuar.	Eksperti vlerëson se kriterë të paarsyeshme dhe jo relevante pengojnë zbatimin korrekt të ligjit.
4	Shkelje e Nenit 25, pika 25.4, 25.5, 25.6 RRPP – Kriteret minimale për kualifikim nuk janë drejtpërdrejt relevante	Eksperti sugjeron që kriteret të modifikohen në mënyrë që të jenë proporcionale, të nevojshme dhe të bazuara në kërkesat reale të projektit.

	dhe proporcionale me objektin e kontratës.	
5	Shkelje e Nenit 27 LPP (Dosja e Tenderit) – Dosja e tenderit përmban kritere jo relevante dhe të panevojshme që kufizojnë konkurrencën.	Eksperti vlerëson se kritere të tilla reduktojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik dhe duhet të rishikohen për të respektuar parimet e transparencës dhe barazisë.
6	Shkelje e Nenit 51 LPP (Njoftimi i kriterëve të përzgjedhjes) – Kriteret e përzgjedhjes nuk janë të kufizuara vetëm në ato të nevojshme për të siguruar aftësitë e OE.	Eksperti sugjeron që kriteret duhet të jenë të qarta, të lidhura me projektin dhe të bazuara në aftësitë reale të operatorëve.
7	Shkelje e Nenit 61.3 RRPP (Afati për shqyrtim të rishqyrtimit) – Kërkesa për rishqyrtim nuk është shqyrtuar brenda 3 ditëve pune dhe nuk ka njoftim për zgjatje.	Eksperti vlerëson se kërkesa për rishqyrtim, për shkak të volumit të saj, ka kërkuar më shumë kohë për shqyrtim. Megjithatë, në rast të tejkalimit të afatit ligjor, autoriteti kontraktues duhet të sigurojë njoftimin e palëve në procedurë, në përputhje me nenin 61.3 të RRPP. Për arsye të transparencës dhe trajtimit të drejtë, rekomandohet që në raste të ngjashme në të ardhmen, zgjatja e afatit të njoftohet publikisht përmes platformës së e-prokurimit.
8	Shkelje e Nenit 62.2 RRPP (Arsyetimi i vendimit) – Vendimi i refuzimit nuk është i arsyetuar individualisht për secilin pretendim.	Eksperti sugjeron që çdo vendim duhet të japë argumente të qarta dhe të lidhura me ligjin, për të siguruar trajtim të drejtë dhe transparent.
9	Shkelje e Nenit 108/A LPP – Refuzimi i kërkesës për rishqyrtim bëhet në kundërshtim me dispozitat, duke mos lejuar shqyrtim meritues.	Eksperti thekson se çdo refuzim duhet të trajtohet me argumente ligjore të bazuara dhe të ndjekë procedurën e saktë, për të mbrojtur të drejtat e OE.
10	Shkelje e Nenit 17, pika 17.17, 17.23 RRPP – Dosja e tenderit nuk siguron konkurrencë të barabartë dhe nuk shmang diskriminimin ndaj OE.	Eksperti sugjeron që kriteret duhet të jenë të dizajnuara për të mbrojtur konkurrencën dhe mosdiskriminimin.

PRETENDIMET KONKRETE TE OPERATORIT EKONOMIK (OE) DHE VLERËSIMI I EKSPERTIT

PRETENDIMI Nr. 1 i OPERATORIT EKONOMIK (OE)

OE ankues pretendon se kriteri i përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues, sipas të cilit operatori ekonomik duhet të ketë auditor të certifikuar sipas standardeve EN ISO 9001:2015, EN ISO 14001:2015 dhe ISO 45001:2018, përveç posedimit të certifikatave ISO për vetë kompaninë, është i panevojshëm dhe joproporcional.

Sipas OE-së, posedimi i certifikatave ISO të lëshuara nga trupa të akredituara konfirmon se kompania ka të implementuar sistemet përkatëse të menaxhimit, i nënshtrohet auditimeve të rregullta dhe plotëson kërkesat për cilësi, mjedis dhe siguri në punë. Kërkesa shtesë për auditorë të certifikuar brenda kompanisë nuk lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës për rregullimin e parqeve dhe krijon barriera të panevojshme për pjesëmarrje, duke kufizuar konkurrencën.

VLERËSIM I EKSPERTIT

Pas shqyrtimit të pretendimit, vlerësohet se certifikatat ISO 9001:2015, ISO 14001:2015 dhe ISO 45001:2018 janë certifikata organizative, të cilat dëshmojnë se sistemi i menaxhimit të operatorit ekonomik është audituar dhe aprovuar nga palë e tretë e pavarur dhe kompetente. Kërkesa për posedim të auditorëve të certifikuar për të njëjtat standarde, për të cilat kompania tashmë është e certifikuar, nuk paraqet vlerë teknike shtesë dhe nuk është e domosdoshme për realizimin e punimeve që përbëjnë objektin e kontratës. Duke qenë se rregullimi i parqeve dhe hapësirave publike nuk kërkon angazhim të drejtpërdrejt të auditorëve ISO, kjo kërkesë vlerësohet si e tepërt dhe jo proporcionale me lëndën e aktivitetit të prokurimit. Në këtë kontekst, certifikatat ISO në pronësi të kompanisë konsiderohen kriter i mjaftueshëm dhe objektiv për vlerësimin e aftësisë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomikë, ndërsa kërkesa shtesë për auditorë të certifikuar mund të ketë efekt kufizues mbi konkurrencën.

KONSTATIM: Pretendimi i OE ankues qendron.

PRETENDIMI Nr. 2 i OPERATORIT EKONOMIK.

OE ankues kundërshton kriterin e Autoritetit Kontraktues, sipas të cilit Udhëheqësi i Punishtes (Inxhinier i Ndërtimtarisë – Konstruktiv) duhet të jetë i certifikuar njëkohësisht në disa fusha, përfshirë sigurinë dhe kontrollin e cilësisë në kantier, mbrojtjen nga zjarri, hidroizolimet në ndërtesa, dhënien e ndihmës së parë dhe punën në lartësi.

Sipas OE-së, këto kërkesa janë të grumbulluara në mënyrë joproporcionale tek një person i vetëm, nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës për rregullimin e parqeve dhe hapësirave publike dhe kufizojnë konkurrencën në mënyrë të pajustifikuar.

OE thekson se:

Në paramasë nuk parashihen punime të hidroizolimit, prandaj certifikimi në këtë fushë nuk ka bazë teknike;

Dhënia e ndihmës së parë është kompetencë bazike dhe nuk lidhet funksionalisht me rolin e udhëheqësit të punishtes;

Punimet në kuadër të kontratës nuk përfshijnë punë në lartësi;

Në praktikën ndërtimore, këto funksione zakonisht mbulohen nga staf i ndryshëm dhe jo nga një person i vetëm, çka krijon dyshim për kufizim të panevojshëm të konkurrencës.

VLERËSIM I EKSPERTIT

Nga shqyrtimi i kriterit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues, vlerësohet se kërkesa për certifikimin e Udhëheqësit të Punishtes në një numër të madh fushash të specializuara, të përqendruara tek një person i vetëm, nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e kontratës.

Objekti i aktivitetit të prokurimit përfshin punime tipike për rregullimin e parqeve dhe hapësirave publike, të cilat realizohen kryesisht në nivel të ulët dhe nuk përfshijnë punime të hidroizolimit, as punë specifike në lartësi. Për rrjedhojë, kërkesat për certifikime në këto fusha vlerësohen si teknikisht të pajustifikuara.

Gjithashtu, certifikimi për dhënien e ndihmës së parë për Udhëheqësin e Punishtes nuk paraqet domosdoshmëri funksionale për këtë pozitë, pasi kjo kompetencë zakonisht mbulohet përmes trajnimeve bazike të stafit dhe nuk ndikon drejtpërdrejt në menaxhimin teknik të punimeve. Në praktikën profesionale të ndërtimit, funksionet e sigurisë në punë, kontrollit të cilësisë, mbrojtjes nga zjarri dhe specializimeve të tjera realizohen zakonisht nga persona të ndryshëm, në përputhje me fushën e tyre të ekspertizës. Përqendrimi i të gjitha këtyre certifikimeve tek një person i vetëm mund të kufizojë në mënyrë të pajustifikuar konkurrencën dhe të krijojë barriera të panevojshme për pjesëmarrje.

KONSTATIM: Pretendimi i OE ankues qendron dhe rekomandohet rishqyrtimi i kriterit.

PRETENDIMI Nr. 3 i OPERATORIT EKONOMIK

OE ankues kundërshton kriterin e Autoritetit Kontraktues, sipas të cilit kërkohet që Inxhinieri Hidroteknik të ketë së paku 5 vite përvojë profesionale dhe të jetë njëkohësisht i certifikuar për mbrojtje nga zjarri, ISO 9001:2015, ISO 50001:2018, si dhe të jetë ekspert i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM).

Sipas OE-së, volumi i punimeve hidroteknike në këtë projekt është minimal dhe përfshin vetëm punime standarde (kanalizime atmosferike dhe ujësjellës të thjeshtë), të cilat nuk kërkojnë certifikime të shumta apo kompetenca të avancuara. OE thekson se kërkesat për certifikime janë të grumbulluara në mënyrë joproporcionale tek një person i vetëm, disa prej tyre janë të përsëritura, ndërsa disa nuk kanë lidhje teknike me objektin e kontratës, duke kufizuar konkurrencën në mënyrë të pajustifikuar.

VLERËSIM I EKSPERTIT

Nga shqyrtimi i kriterit të përcaktuar për Inxhinierin Hidroteknik, vlerësohet se kërkesa për një numër të madh certifikimesh dhe kompetencash të specializuara, të përqendruara tek një person i vetëm, nuk është proporcionale me objektin dhe vëllimin e punimeve të përfshira në këtë aktivitet të prokurimit.

Punimet hidroteknike janë të natyrës standarde dhe përbëjnë pjesë të vogël të projektit, çka nuk arsyeton kërkesa për certifikime të shumta të nivelit të lartë. Kërkesat për certifikim në mbrojtje nga zjarri dhe ISO 9001:2015 vlerësohen si të dyfishuara, pasi këto kompetenca tashmë mbulohen nga pozicione të tjera të kërkuara në kuadër të kontratës ose nga certifikimi i kompanisë.

Kërkesa që Inxhinieri Hidroteknik të jetë i certifikuar sipas ISO 50001:2018 vlerësohet si teknikisht e pajustificuar, pasi ky standard lidhet me sistemin e menaxhimit të energjisë dhe nuk ka lidhje me punimet hidroteknike apo me rregullimin e parqeve dhe hapësirave publike. Gjithashtu, kërkesa që i njëjti inxhinier të jetë ekspert i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis nuk është në përputhje me profilin profesional të Inxhinierit Hidroteknik dhe nuk paraqet domosdoshmëri për realizimin e punimeve të parashikuara.

KONSTATIM: Pretendimi i OE-së konsiderohet i bazuar; rekomandohet rishqyrtimi i kriterit.

PRETENDIMI Nr. 4 i OPERATORIT EKONOMIK

OE ankues kundërshton kriterin e Autoritetit Kontraktues, sipas të cilit kërkohet që Inxhinieri i Arkitekturës, me së paku 3 vite përvojë profesionale, të jetë i certifikuar për mbrojtje nga zjarri.

Sipas OE-së, kjo kërkesë është e panevojshme dhe e përsëritur, pasi certifikimi për mbrojtje nga zjarri tashmë mbulohet nga pozicione të tjera profesionale të kërkuara në tender, si dhe nga kërkesat e përgjithshme për siguri dhe shëndet në punë për stafin. Vendosja e së njëjtës kërkesë edhe për Inxhinierin e Arkitekturës nuk shton vlerë teknike dhe krijon ngarkesë të panevojshme për operatorët ekonomikë.

VLERËSIM I EKSPERTIT

Kërkesa për certifikim në mbrojtje nga zjarri nuk lidhet drejtpërdrejt me rolin funksional të arkitektit në kuadër të këtij aktiviteti të prokurimit, i cili ka të bëjë me rregullimin e parqeve dhe hapësirave publike.

Duke marrë parasysh se certifikimi për mbrojtje nga zjarri është kërkuar tashmë për staf tjetër profesional dhe se aspektet e sigurisë mbulohen edhe përmes kërkesave të përgjithshme për siguri dhe shëndet në punë, kjo kërkesë rezulton të jetë e dyfishuar dhe pa vlerë teknike shtesë.

KONSTATIM: Pretendimi i OE-së është i bazuar; rekomandohet rishqyrtimi ose heqja e kriterit.

PRETENDIMI Nr. 5 i OPERATORIT EKONOMIK

OE ankues kundërshton kriterin e Autoritetit Kontraktues, sipas të cilit kërkohet që Inxhinieri i Ambientit, me së paku 5 vite përvojë profesionale, të jetë njëkohësisht ekspert për vlerësimin e ndikimit në mjedis, i certifikuar me ISO 14001:2015 dhe i certifikuar për menaxhimin e projekteve.

Sipas OE-së, kërkesa për certifikim ISO 14001:2015 për individin është e panevojshme dhe joproporcionale, pasi ky standard tashmë kërkohet dhe plotësohet në nivel kompanie. Dublimi i këtij kriteri nuk shton vlerë teknike dhe krijon ngarkesë të panevojshme për operatorët ekonomikë. Po ashtu, OE pretendon se kërkesa për ekspert të vlerësimit të ndikimit në mjedis nuk është e arsyetuar, pasi objekti i kontratës nuk përfshin aktivitete apo materiale që kërkojnë procedura të tilla.

VLERËSIM I EKSPERTIT

Kërkesa për certifikim individual sipas ISO 14001:2015 nuk është e nevojshme, duke qenë se ky standard është tashmë i kërkuar dhe i dëshmuar në nivel organizativ për operatorin ekonomik. Certifikimi i kompanisë garanton ekzistencën dhe zbatimin e sistemit të menaxhimit mjedisor, ndërsa dublimi i tij për individin nuk sjell përfitim teknik shtesë.

Sa i përket kërkesës që Inxhinieri i Ambientit të jetë ekspert i vlerësimit të ndikimit në mjedis, bazuar në objektin e kontratës dhe natyrën e punimeve për rregullimin e parqeve dhe hapësirave publike, nuk rezulton se parashihen aktivitete që kërkojnë procedura formale të VNM-së. Kjo kërkesë vlerësohet si teknikisht e pajustificuar dhe jo proporcionale.

KONSTATIM: Pretendimi i OE-së është i bazuar; rekomandohet rishqyrtimi ose heqja e kërkesave për certifikimin individual ISO 14001:2015 dhe ekspertizën VNM.

PRETENDIMI NR. 6 i OPERATORIT EKONOMIK

OE ankues kundërshton kërkesën e Autoritetit Kontraktues për posedimin e personelit të specializuar për saldim, konkretisht:

një saldues,

një saldues i certifikuar sipas EN ISO 9606-1 me minimum 2 vite përvojë pune,

një “saldator” sipas EN ISO 9712:2012, me certifikatë të verifikueshme online dhe kontratë pune ose angazhimi.

Sipas OE-së, këto kërkesa janë joproporcionale dhe të papërshtatshme me natyrën e punimeve, pasi nga paramasa rezulton se punimet e saldimit kufizohen në rrethoja të thjeshta metalike, të cilat nuk kërkojnë saldim të specializuar apo inspektime të avancuara. OE thekson se standardi EN ISO 9712:2012 nuk lidhet me certifikimin e salduesve, por me inspektorë të kontrollit jo-shkatërrues (NDT), ndaj kërkesa për këtë certifikim është e pakuptimtë dhe pa lidhje me objektin e kontratës.

VLERËSIM I EKSPERTIT

Nga shqyrtimi i kërkesave për personelin e saldimit, vlerësohet se natyra dhe vëllimi i punimeve që përfshijnë saldim, sipas paramasës, janë të kufizuara dhe përbëhen nga punime të thjeshta metalike, të cilat nuk kërkojnë personel me certifikime të shumëfishta apo të avancuara.

Kërkesa për të patur të paktën një saldues të certifikuar sipas EN ISO 9606-1 mund të konsiderohet e arsyeshme në parim.

Megjithatë, kërkimi paralel dhe shtesë i personelit sipas EN ISO 9712:2012 është teknikisht i pajustificuar, pasi ky standard lidhet me kualifikimin e inspektorëve të kontrollit jo-shkatërrues (NDT) dhe jo me kryerjen e punimeve të saldimit.

Për më tepër, kërkesa specifike për verifikim online të certifikatës sipas EN ISO 9712:2012, e kombinuar me mungesën e lidhjes funksionale të këtij certifikimi me projektin, krijon dyshim të arsyeshëm për kufizim të panevojshëm të konkurrencës.

Në këtë kontekst, grumbullimi i disa kërkesave të ndryshme për saldim, të cilat tejkalojnë nevojat reale të projektit, vlerësohet si joproporcional dhe jo i lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës.

KONSTATIM I EKSPERTIT

Bazuar në analizën e mësipërme, pretendimi i OE-së vlerësohet si **i bazuar pjesërisht**:

Kërkesa për posedimin e një salduesi të certifikuar mund të konsiderohet e nevojshme;

Ndërsa kërkesa për personel sipas EN ISO 9712:2012 vlerësohet si e panevojshme, e papërshtatshme dhe jo proporcionale për këtë aktivitet të prokurimit.

EKOMANDIM: Rishqyrtimi i kriterit dhe heqja e kërkesës për certifikim sipas EN ISO 9712:2012.

PRETENDIMI NR. 7 i OPERATORIT EKONOMIK

OE ankues kundërshton kërkesën e Autoritetit Kontraktues që personi i angazhuar për sistemet e drenazhimit të jetë i certifikuar për:

siguri dhe shëndet në punë,

mbrojtje nga zjarri.

Sipas OE-së, këto kërkesa janë të panevojshme dhe joproporcionale, pasi kompetencat për siguri dhe mbrojtje nga zjarri tashmë mbulohen nga stafi profesional ekzistues dhe nga personi përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë. Natyra e punimeve (hapje kanalesh atmosferike dhe sistemi i ujitjes) nuk kërkon certifikime të veçanta për individë të rinj. OE thekson se kjo kërkesë krijon vetëm barrë shtesë për operatorët ekonomikë dhe kufizon konkurrencën pa arsye. Gjithashtu, kompania e ofruesit të shërbimeve është e pajisur me vlerësim të rrezikut, duke garantuar që të gjithë punonjësit i nënshtrohen trajnimeve për siguri

dhe shëndet në punë, çka bën të tepërt kërkesën që specifikisht individ i angazhuar të ketë certifikimin.

VLERËSIM I EKSPERTIT

Nga shqyrtimi i kërkesës për personin e angazhuar në sistemet e drenazhimit, vlerësohet se:

Certifikimet për siguri dhe shëndet në punë dhe mbrojtje nga zjarri për individin specifik janë të panevojshme, pasi këto funksione mbulohen nga stafi profesional ekzistues dhe nga personi përgjegjës për sigurinë në punë;

Punimet reale të projektit nuk kanë rrezik të lartë që të kërkojë certifikim shtesë për individin në fjalë;

Shtimi i këtij kriteri është joproporcionale dhe mund të krijojë kufizime të panevojshme për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

KONSTATIM I EKSPERTIT

Pretendimi i OE-së vlerësohet si **i bazuar**, pasi kërkesa për certifikim të veçantë për individin për siguri dhe mbrojtje nga zjarri nuk ka nevojë teknike dhe është e tepërt në kontekstin e këtij aktiviteti të prokurimit. **Rekomandim:** Heqja e këtij kriteri nga kërkesat e kualifikimit.

PRETENDIMI NR. 8 i OPERATORIT EKONOMIK

OE ankues kundërshton kërkesën që eskavatori i përdorur në projekt të ketë krahe të gjatë minimum 18 metra. Sipas OE-së, kjo kërkesë është e panevojshme për aktivitetet e parashikuara në projekt, të cilat përfshijnë punime në parqe dhe hapësira publike, ku hapësirat janë të mjaftueshme dhe nuk kërkojnë përshkueshmëri në zona të thella ose të kufizuara. Kërkesa e tillë krijon vetëm ngarkesë shtesë për operatorët ekonomikë, pa kontribuar në nevojën reale teknike të projektit. OE thekson se eskavatorë me krahe të gjatë përdoren zakonisht në situata specifike, si pastrimi i lumenjve të gjërë ose për manipulimin e kontenjereve në porte, dhe jo për punime të hapësirave publike të parqeve.

VLERËSIM I EKSPERTIT

Nga shqyrtimi i kërkesës për eskavator me krahe të gjatë, vlerësohet se:

Në kontekstin e këtij projekti, punimet përfshijnë rregullimin e parqeve, trotuareve dhe hapësirave publike, ku hapësirat janë të mjaftueshme dhe nuk kërkojnë lartësi ose përshkueshmëri të madhe;

Kërkesa për krahe 18 metra është e panevojshme në standardet e zakonshme të projekteve të këtij lloji dhe nuk sjell vlerë teknike shtesë;

Praktika e zakonshme në projekte të ngjashme të rregullimit të hapësirave publike nuk kërkon eskavatorë me krahe të gjatë; mjafton një makineri standarde që mund të kryejë gërmimin dhe lëvizjen e tokës ose mbetjeve të vogla.

Megjithatë, në projekte specifike (lumë, porte, zona të thella) eskavatorë me krahe të gjatë mund të jenë të nevojshëm, por ky nuk është rasti i këtij aktiviteti të prokurimit.

KONSTATIM I EKSPERTIT

Pretendimi i OE-së vlerësohet si **i bazuar**, pasi kërkesa për eskavator me krahe 18 metra nuk është proporcional me objektin e projektit dhe për punimet e parashikuara është e panevojshme. **Rekomandim:** Hiqet ose modifikohet ky kriter për të lehtësuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë dhe për të shmangur barrierat të panevojshme.

PRETENDIMI NR. 9 i OPERATORIT EKONOMIK

OE ankues kundërshton kërkesën për një cilindër ngjeshës me peshë minimale 25 ton. Sipas OE-së, kjo kërkesë nuk korrespondon me pozicionet e ngjeshjes të përshkruara në paramasë, ku kërkohet arritja e ngjeshmërisë $M_v > 50 \text{ daN/cm}^2$. OE thekson se për të arritur këtë ngjeshmëri, cilindra më të lehtë janë të mjaftueshëm, nëse fraksionet e zhavorrit dhe paramasat janë të përshtatshme. Kërkesa për një cilindër të rëndë 25 ton krijon ngarkesë të panevojshme dhe kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, duke kërkuar një mjet më të rrallë dhe më të shtrenjtë se sa është teknikisht i nevojshëm.

VLERËSIM I EKSPERTIT

Nga shqyrtimi teknik i kërkesës për cilindrin ngjeshës:

Për ngjeshmërinë e kërkuar $M_v > 50 \text{ daN/cm}^2$, cilindra më të lehtë janë të mjaftueshëm, sipas praktikave të zakonshme në ndërtim dhe përvojës profesionale;

Kërkesa për peshë minimale 25 ton nuk është proporcional me funksionin e nevojshëm dhe nuk përputhet me specifikimet e paramasës;

Modifikimi i kërkesës për të lejuar përdorimin e cilindra më të lehtë do të ruajë funksionin teknik të projektit, ndërsa do të zvogëlojë ngarkesën dhe barrierat për operatorët ekonomikë.

KONSTATIM I EKSPERTIT

Pretendimi i OE-së vlerësohet si **i bazuar**; rekomandohet modifikimi i specifikimit teknik, duke lejuar përdorimin e cilindra më të lehtë dhe më praktik për aktivitetin.

PRETENDIMI NR. 10 i OPERATORIT EKONOMIK

OE ankues kundërshton kërkesën për një kamion kiper me kran dhe platformë (kosh teleskopik 15 m) me peshe bartëse deri 7 ton, ku kërkohet gjithashtu bashkëngjitja e certifikatës së regjistrimit dhe raportit të kontrollit teknik nga kompani e licencuar.

Sipas OE-së, kjo kërkesë është e tepërt dhe e joproportionale për aktivitetet e parashikuara në projekt. Në paramasë nuk parashikohen punime që kërkojnë platformë me lartësi 15 m, dhe edhe nëse kishte punë të vogla me lartësi, ato mund të kryheshin me skela të thjeshta. Për më tepër, kombinimi i të gjitha specifikimeve (kipper, platformë, kran, pesha maksimale 7 ton, certifikime) krijon një kriter shumë të ngushtë, që mund të plotësohet vetëm nga një operator që posedon saktësisht këtë mjet. OE thekson se kjo kërkesë nuk është proporcional me objektin e kontratës dhe kufizon konkurrencën pa arsye.

VLERËSIM I EKSPERTIT

Nga shqyrtimi i kërkesës për kamionin kiper me platformë dhe kran:

Për punimet e projektit, të cilat përfshijnë rregullimin e parqeve dhe hapësirave publike, nuk ka nevojë për platformë 15 m;

Materialet mund të shkarkohen me kipper standard, dhe punimet e larta (nëse ka) mund të kryhen me skela ose mjete të thjeshta;

Kombinimi i kërkesave të shumta tek një mjet i vetëm (kipper + kran + platformë + pesha bartëse 7 ton + certifikime) është joproportionale, dhe praktikisht krijon një barrë të panevojshme për operatorët ekonomikë;

Praktikat e zakonshme në projekte të ngjashme nuk kërkojnë mjete kaq specifike; zakonisht përdoret një kamion standard me pajisje të ndara sipas nevojës.

KONSTATIM I EKSPERTIT

Pretendimi i OE-së vlerësohet si **i bazuar**; rekomandohet heqja ose modifikimi i kriterit për të lehtësuar pjesëmarrjen dhe për të ruajtur proporcionalitetin e kërkesave.

PRETENDIMI NR. 11 i OPERATORIT EKONOMIK

OE ankues kundërshton kërkesën për një grejder nivelizues digjital me peshe 8-10 ton, duke argumentuar se kufizimi i tonazhit dhe kërkesa për version digjital janë të panevojshme dhe mund të kufizojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë. OE propozon që Autoriteti Kontraktues të lejojë një gamë më të gjerë të grejderëve, pa domosdoshmërinë për version digjital, në mënyrë që ofertimi të mos pengohet nga një kriter tepër specifik. Kjo do të sigurojë përshtatshmëri teknike me kërkesat reale të projektit dhe do të shmangë barriera të panevojshme për pjesëmarrësit.

VLERËSIM DHE REKOMANDIM I EKSPERTIT

1. Tonazhi 8–10 ton:

Mund të ketë bazë teknike, por nuk është domosdoshmëri absolute.

AK mund të rishqyrtojë këtë kufizim sipas nevojave reale të projektit.

2. Nivelimi digjital:

Kërkesa për nivelim digjital është e nevojshme për sigurimin e cilësisë dhe precizitetit të punimeve.

Pretendimi i OE-së për heqjen e tij nuk pranohet.

KONSTATIM I EKSPERTIT

Nivelimi digjital mbetet kriter i detyrueshëm;

Kufizimi i tonazhit mund të rishikohet nga AK sipas nevojës reale dhe proporcionalitetit.

PRETENDIMI NR. 12 i OPERATORIT EKONOMIK

OE kundërshton kërkesën për një rul ngjeshës me xhemba dhe lopatë rrafshuese, me peshë deri 4 ton, duke argumentuar se:

Kërkesa është shumë specifike dhe e kufizuar në treg, duke krijuar barrierë për operatorët ekonomikë;

Pjesa e lopatave për rrafshim është e panevojshme, pasi shtresat e zhavorrit mund të nivelizohen me grejderin;

Xhembat në rul janë të domosdoshëm vetëm për materiale jo të lidhura, dhe zhavorri cilësor i përdorur nuk e bën këtë të nevojshme.

VLERËSIM I EKSPERTIT

Përdorimi i xhembave dhe lopatës nuk është domosdoshmëri absolute;

Diskrecioni i vendosjes së mjetit mbetet te Autoriteti Kontraktues;

KONSTATIM I EKSPERTIT

Pretendimi i OE-së vlerësohet si **i bazuar**, duke lënë diskrecion AK-së për vendimin final mbi nevojshmërinë e mjetit.

PRETENDIMI NR. 13 i OPERATORIT EKONOMIK

OE kundërshton kërkesën për sharrë hidraulike të montuar në eskavator, duke argumentuar se:

Funksioni mund të realizohet me mjete të tjera;

Për punimet e thjeshta, mjetet standarde janë të mjaftueshme;

Kërkesa është shumë specifike dhe joproporcionale.

VLERËSIM I EKSPERTIT

Përdorimi i sharrës në eskavator nuk është domosdoshmëri absolute;

Mjete alternative janë praktikisht të mjaftueshme;

KONSTATIM I EKSPERTIT

Pretendimi i OE-së vlerësohet si **i bazuar**, vendimi për përdorimin e sharrës mbetet në diskrecion të AK-së.

PRETENDIMI NR. 14 i OPERATORIT EKONOMIK

OE kundërshton kërkesën për kompresor gjysmë-rimorkio për thyerje betoni, duke argumentuar se:

Funksioni i tij është i njëjtë me eskavatorin me çekan 7t;

Përdorimi i dy mjeteve të ndryshme është i panevojshëm;

AK duhet të ketë diskrecion për të zgjedhur njërin mjet.

VLERËSIM I EKSPERTIT

Funksioni i kompresorit dhe i eskavatorit është i njëjtë;

Kërkesa për kompresor nuk është domosdoshmëri teknike;

KONSTATIM I EKSPERTIT

Pretendimi i OE-së vlerësohet si **i bazuar**, vendimi për përdorim mbetet në diskrecion të AK-së.

PRETENDIMI NR. 15 i OPERATORIT EKONOMIK

OE kundërshton kërkesën për skip ngarkues 4x4 me lugë para/mbrapa 8–10 ton, duke argumentuar se:

Funksioni i ngarkimit mbulohet nga eskavatorët;

Specifikimi i tonazhit është i tepërt dhe kufizon konkurrencën;

AK duhet të lejojë gamë më të gjerë tonazhi.

VLERËSIM I EKSPERTIT

Funksioni mund të kryhet edhe nga mjete të tjera;

Vendimi për tonazhin dhe nevojën mbetet në diskrecion të AK-së.

KONSTATIM I EKSPERTIT

Pretendimi i OE-së vlerësohet si **i bazuar**, duke rekomanduar gamë më të gjerë tonazhi për fleksibilitet dhe proporcionalitet.

PRETENDIMI NR. 16 i OPERATORIT EKONOMIK

OE kundërshton kërkesën për eskavator me sistem nivelimi digjital 3.5–6t, duke argumentuar se:

- Kërkesa është shumë specifike dhe joproportionale për punimet e thjeshta;
- Nivelimi digjital mund të realizohet edhe me grejder ose instrumente matëse me laser;
- Propozohet gamë më e gjerë tonazhi dhe eliminim i nivelimit digjital të detyrueshëm.

VLERËSIM I EKSPERTIT

- Nivelimi digjital rrit saktësinë dhe cilësinë;
- Për disa pozicione, funksioni mund të arrihet edhe me mjete alternative;

KONSTATIM I EKSPERTIT

Pretendimi i OE-së vlerësohet si **pjesërisht i bazuar**:

1. Nivelimi digjital mbetet kriter teknik;
2. AK mund të lejojë mjete alternative (grejder, laser) që sigurojnë saktësinë e kërkuar;
3. Vendimi i aplikimit të kriterit mbetet në diskrecion të AK-së.

PRETENDIMI NR. 17 i OPERATORIT EKONOMIK

OE kundërshton kërkesën për kamion kiper 1–1.2t, duke argumentuar se:

- Tonazhi i ngushtë kufizon pjesëmarrjen e operatorëve;
- AK duhet të lejojë gamë më të gjerë tonazhi për të ruajtur konkurrencën e drejtë dhe fleksibilitetin.

VLERËSIM I EKSPERTIT

- Tonazhi 1–1.2t nuk është proporcional me natyrën e punës;
- Vendimi për gamën e tonazhit mbetet në diskrecion të AK-së;
- Kërkesa aktuale mund të kufizojë pjesëmarrjen pa arsye.

KONSTATIM I EKSPERTIT

Pretendimi i OE-së vlerësohet si **i bazuar**, duke rekomanduar zgjerimin e gamës së tonazhit dhe lënien e vendimit për nevojën reale të AK-ja

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Euro Commere”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rregullimi I parqeve dhe hapsirave publike në zonën urbane të qytetit Lot 1 deri në Lot 4 “ me numër të prokurimit: “651-25-9957-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL- GJILAN

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **Euro Commere**



Bekim Lushaku